



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE

UDHËZIM ADMINISTRATIV (SZP) NR. 01/2021
PËR REALIZIMIN E VIZITAVE TË ORGANIZUARA
NË PRESIDENCË

Prishtinë, 30.06.2021.



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PRESEDNICE

Sekretari i Zyrës së Presidentes,

Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009), si dhe nenit 18 të Rregullores (P) Nr. 02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës (08.09.2016), nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (SZP) NR. 01/2021 PËR REALIZIMIN E
VIZITAVE TË ORGANIZUARA NË PRESIDENCË**

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ përcakton rregullat për realizimin e vizitave të organizuara në Presidencë.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet nga:
 - 1.1. stafi i Presidencës, dhe
 - 1.2. vizitorët në Presidencë.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **President/e** – Presidenti/ja i/e Republikës së Kosovës;
 - 1.2. **Presidencë** - selia e aktivitetit zyrtar të Presidentit/es, që përfshin Kabinetin e Presidentit/es, Zyrën e Presidentit/es dhe institucionet/njësitë tjera të ndërlidhura;
 - 1.3. **Zyra e Presidentit/es** - është njësi e Presidencës dhe institucion i veçantë në kuadër të Shërbimit Civil të Kosovës;

- 1.4. **Sekretari/e** - Sekretari/ja i/e Zyrës së Presidentit/es;
- 1.5. **Staf i Presidencës** - këshilltarët/et e Presidentit/es, nëpunësit/et civil/e në Presidencë dhe stafi mbështetës në Kabinetin e Presidentit/es;
- 1.6. **Departament** - Departamenti përkatës për informim dhe komunikim me publikun në Presidencë;
- 1.7. **Vizitorë** - nënkupton personat të cilët janë në objektet e Presidencës për qëllime të vizitave të organizuara;
- 1.8. **Organizime të Presidentit/es** – ngjarje apo aktivitete i organizuar nga apo nën përkujdesjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të Presidentit/es.

KAPITULLI II – REALIZIMI I VIZITAVE TË ORGANIZUARA NË PRESIDENCË

Neni 4

Vizitat në Presidencë

1. Kërkesa për vizitë në Presidencë, paraqitet së paku pesë (5) ditë para datës së vizitës dhe përmban:
 - 1.1. emrin dhe kontaktet e vizitorit/es apo përfaqësuesit/es të/së grupit të organizuar;
 - 1.2. datën dhe orën e propozuar të vizitës;
 - 1.3. numrin dhe emrat e vizitorëve/eve; si dhe
 - 1.4. qëllimin e vizitës.
2. Kërkesa, sipas paragrafit 1 të këtij neni i bartet Departamentit, i cili e shqyrton kërkesën dhe ia paraqet për aprovim Sekretarit/es.
3. Sipas njoftimit dhe arsytimit të zyrtarit të Departamentit, vizitën e aprovon Sekretari/ja.
4. Zyrtari i Departamentit, pas aprovimit të vizitës nga Sekretari/ja, e njofton përfaqësuesin/en e grupit të organizuar për datën dhe orën e vizitës, si dhe për kodin e sjelljes.
5. Sekretari/ja, për shkakë sigurie mund të shtyjë lejimin e vizitës ose ta ndërpres vizitën gjatë realizimit, nëse e vlerëson si të nevojshme.
6. Kërkesa për vizitë në Presidencë, mund të bëhet sipas Shtojcës 1 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 5

Pjesëmarrja në organizime të Presidentit/es

1. Vizitorët/et, mund të përcjellin dhe apo të marrin pjesë në organizime të ndryshme të Presidentit/es, pas njoftimit publik apo ftesës paraprake.
2. Kërkesa dhe aprovimi për të marrë pjesë në këto organizime bëhet përshtatshmerisht sipas procedurave të përcaktuara në nenin 4 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 6 Pritja

Vizitorët/et në momentin e arritjes në Presidencë, priten nga zyrtari/ët i/e Departamentit, i nënshtrohen kontrollit të sigurisë, në pajtim me legjislacionin përkatës për ruajtjen, sigurimin dhe qasjen në objektet shtetërore.

Neni 7 Akomodimi

1. Vizitorët/et akomodohen në hapësirat e caktuara për ta.
2. Presidenca, i siguron vizitorëve/eve hapësirat e përshtatshme dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e vizitës sipas qëllimit të përcaktuar.

Neni 8 Shoqërimi

Zyrtari i Departamentit, siguron shoqërim të vazhdueshëm për vizitorët/et gjatë qëndrimit të tyre në Presidencë.

Neni 9 Mbajtja e rendit

1. Zyrtari e Departamentit paraprakisht i njofton vizitorët/et për mënyrën e sjelljes dhe mbajtjes së rendit dhe qetësisë, gjatë vizitës në Presidencë.
2. Vizitorët/et, gjatë kohës sa ndodhën në hapësirat e Presidencës, detyrohen t'i përmbahen rendit dhe rregullave të sjelljes në Presidencë.
3. Në hapësirat e Presidencës në parim nuk lejohen xhirimi dhe fotografimi, përjashtimisht xhirimet dhe fotografimet në hapësirat e caktuara, mund të bëhet vetëm me pëlqimin paraprak të Departamentit.
4. Gjatë përcjellës së aktivitetit, është i ndaluar çdo veprim që e pengon punën, si të folurit me zë të lartë, përdorimi i telefonave mobil, fotografimi si dhe çdo gjë tjetër që bie ndesh me rendin e ngjarjes dhe të cilat e pengojnë dhe e vështirësojnë zbatimin e aktivitetit.
5. Nëse ndonjëri/a nga pjesëmarrësit/et nuk i përmbahet rendit dhe rregullave të sjelljes në Presidencë, Departamenti, nëse e vlerëson si të nevojshme, mund ta ndërpres vizitën gjatë realizimit apo mund të largojë nga ndërtesa personin e caktuar që bën shkeljen.

Neni 10
Përcjellja

Zyrtari i Departamentit, siguron dhe kujdeset që pas përfundimit të vizitës t'i shoqëron vizitorët/et deri në dalje të tyre nga Presidenca.

KAPITULLI III – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Fehmi MEHMETI

u.d. Sekretar i Zyrës së Presidentes

Prishtinë, 30.06.2021.

Shtojca Nr. 1: Kërkesa për vizitë të organizuar në Presidencë



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE

Emri dhe mbiemri i vizitorit/es/përfaqësuesit/es të/së grupit të organizuar	
Numri i telefonit: E-maili:	
Data dhe ora e propozuar e vizitës	
Numri dhe emrat e vizitorëve/eve	
Qëllimi i vizitës:	

DEKLARATË PERSONALE

Unë, (emri, mbiemri) _____

DEKLAROJË SE: Të gjitha informacionet e dhëna dhe të bashkangjitura janë të sakta

- **VËREJTJE:** *Deklarata dhe prezantimi i të dhënave si dhe dëshmime të rrejshme ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi!*

Nënshkrimi:

Data: ____ . ____ . ____